



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1490/2Prot.

Pukë, me 04.09.2025

V E N D I M

Nr. 29, datë 04.09.2025

“Per miratimin e projektit me objekt: “Masa rehabilituese te bodrumit te pallatit nr. 50 I demtuar nga ujrat e zeza Njesia Administrative Puke Bashkia Puke” me fondin e kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile”
Bazueshmëria ligjore e P/ Vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30 shkronja “gj”, VKM nr. 414 date 08.07.2021 “Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile , i ndryshuar me VKM nr. 290 date 17.05.2023, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.492/1 Prot date 25.02.2025 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Për sa më sipër, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Finances si dhe Kryetari i Bashkisë Puke për të marrë masa rehabilituese te bodrumit te pallatit nr. 50 I demtuar nga ujrat e zeza Njesia Administrative Puke Bashkia Puke, i propozon Këshillit Bashkiak. i cili pas shqyrtimit :

V E N D O S I :

1. Të miratojë Projektin me objekt: “Masa rehabilituese te bodrumit te pallatit nr. 50 i demtuar nga ujrat e zeza Njesia Administrative Puke Bashkia Puke” nga fondi i Kushtezuar i buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile më vlere 1199995.53 **leke** , me kod produkti 91707AG , sipas shkresës nr. 492/1 Date 25.02.2025 “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances , Sektori i Emergjencave Civile
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).
4. Vendimi u shpall me date 04.09.2025
Vota te vlefshme gjithsej 10
Vota pro 10 , Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon GJOKA



22.09.25

H. Terziu
F. Iatri
B. Ademi
F. Iatri
F. Iatri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 13.09.2025

Nr. 585/1
prot.



Lënda: Mbi Vendimin Nr. 29, datë 04.09.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe Aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, pika 1, neni 37, pika 1, shkronja "c", neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 3, pika 13, neni 22, pika 3, neni 27, ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30, shkronja "f", "gj", neni 41, pika 1, 2, të VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, pika 3.1, shkronjat "b", "c" dhe "gj", të shkresës së AKMC nr. 492/1 prot., datë 25.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të shtetit për mbrojtjen civile", të VKB Pukë Nr. 64/2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", të ndryshuar, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Nr.1482/4 prot., datë 08.09.2025 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit të Bashkiak Pukë", shqyrtoi VKB Pukë nr. 29, datë 04.09.2025 "Për përdorim të fondit të kushtëzuar me kod 91707AG¹ për marrjen e masave rehabilituese të bodrumi nr.50 i demtuar nga ujrat e zeza NJAD Pukë në vlerën prej 1.199.995.53 lekë miratuar me VKB Pukë Nr. 64/2024".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Ju sqarohet se nuk është tagër i KB të miratojë një projekt në fushën e mbrojtjes civile.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI



¹ Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese